1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë përkatëse në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;

d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;

e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

- Shtojca 1: Kërkesë për pjesëmarrje
- Shtojca 2: Ftesa për Propozim
- Shtojca 3: Formulari i Deklarimit të Propozimit
- Shtojca 4: Formulari i Propozimit Ekonomik
- Shtojca 5: Formulari i Sigurimit të Ofertës
- Shtojca 6: Lista e Informacionit Konfidencial
- Shtojca 7: Deklaratë për disponueshmërinë e stafit të konsulentit
- Shtojca 8: Formulari i Specifikimeve Teknike
- Shtojca 9: Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit
- Shtojca 10: Formulari i Termave të Referencës
- Shtojca 11: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve
- Shtojca 12: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit
- Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të skualifikimit
- Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraparak)
- Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Fituesit (Në përfundim të afateve të ankimit)
- Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Paraparak)
- Shtojca 17: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Në përfundim të afateve të ankimit)

Shtojca 1

[Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik]

KËRKESË PËR PJESËMARRJE

(Emri i operatorit ekonomik dhe NIPT-i)

[Data_____]

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Procedura e prokurimit: [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Unë (Ne), të nënshkruarit, paraqesim kërkesën tonë për pjesëmarrje për këtë procedurë:

Emri i Përfaqësuesit të Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Datë

Shtojca 2

[Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti/enti kontraktor]

FTESË PËR PROPOZIM

(Vetëm për kandidatët e përzgjedhur pas shqyrtimit të kërkesave për pjesëmarrje)

[Data]

Për : [Emri dhe adresa e ofertuesit të përzgjedhur]

Procedura e Prokurimit: _____

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, ju informojmë se [emri dhe adresa e kandidatit të përzgjedhur], pas vlerësimit të dokumentave të paraqitura në fazën e parë, jeni kualifikuar për në fazën e paraqitjes së propozimeve.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë _____ (emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor)

propozimin tuaj, duke marrë parasysh se:

Afati kohor për dorëzimin dhe hapjen e propozimit është :

Data, ora dhe adresa

Data: □□/□□/□□□□(d/m/v) ora □□:□□

Adresa: _____

Kur propozimi kërkohet të paraqitet në mënyrë elektronike, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë propozimin në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të APP-së, [ëëë.app.gov.al](http://eeë.app.gov.al)

Informacioni mbi propozimet e paraqitura me mjete elektronike, i transmetohet të gjithë atyre Operatorëve Ekonomikë që kanë dorëzuar propozime, në bazë të kërkesës së tyre.

Gjuha(-ët) për hartimin e propozimeve janë:

Shqip

Anglisht

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit :

Autoriteti/Enti Kontraktor rendit propozimet sipas rezultateve teknike e financiare të kombinuara, duke përdorur peshën e treguar në Dokumentat e Tenderit. Ofertuesi që arrin rezultatin më të lartë të kombinuar teknik e financiar do të ftohet për negociata për lidhjen e kontratës.

Jemi në pritje të propozimit tuaj.

Titullari i Autoritetit/Entit Kontraktor

Shtojca 3

[Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik]

FORMULARI I DEKLARIMIT TË PROPOZIMIT

[Data_____]

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Procedura e prokurimit: [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/ Nr. Referencës në faqen e APP-së

Emri i operatorit ekonomik dhe NIPT-i

Unë (Ne), të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor [**vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor**], në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për [**vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE**] në përputhje me grafikun e kërkuar të kryerjes së shërbimit.
- (d) Ne nuk marrim pjesë si kandidatë në më shumë se një propozim në këtë procedurë prokurimi.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 2. Njoftimin e Kontratës;
 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 4. Specifikimet teknike dhe termat e referencës;
 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës.
- e) Çmimi Total i propozimit tonë është shprehur në propozimin ekonomik.

Emri i Përfaqësuesit të Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Datë

Shtojca 4

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik*]

FORMULARI I PROPOZIMIT EKONOMIK

Tarifat sipas Kategorisë së Punës : (Nëntotali i detajuar)

Pagesat Ditore: (Nëntotali i detajuar)

Kostot e Drejtpërdrejta: (Nëntotali i detajuar)

Shpenzimet e Rimbursueshme: (Nëntotali i detajuar)

TOTALI

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5

[*Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik*]
[*Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve*]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;

- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 6

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial:

çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

DEKLARATË **Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit të konsulentit¹**

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Në bazë të parashikimeve të neneve 41 dhe 54 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të Konsulentit “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM Konsulentin “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo konsulenti tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt _____, është i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

¹ Kjo deklaratë duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të stafit të konsulentit dhe do të jetë pjesë e dokumentave të ofertës së konsulentit.

3. Nuk ndodhem në kushtet e konfliktit të interesit, *me asnjë* nga anëtarët e stafit të autoritetit/entit kontraktor, drejtpërdrejtë ose jo, i përfshirë në ndonjë pjesë të përgatitjes së kushteve të kontratës dhe/ose në procesin e përzgjedhjes për këtë kontratë dhe/ose për mbikëqyrjen e kësaj kontrate.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

Shtojca 8

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor*]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmartje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 9

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet:

HARTIM PROJEKTESH " Rikonstruksioni i Fasadave të qytetit të policanit" , "Ndërtimi i Parkimit Nëntokësor dhe hapësirës Rekreative", "Reabilitimi i Kombinatit Mekanik të qytetit të Policanit"

Afat ekzekutimi brenda 60 ditësh. nga nenshkrimi i kontartes.

Afatet e ekzekutimit:

Shtojca 10

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

➤ **DETYRE PROJEKTIMI: “Rikonstruksioni i Fasadave të qytetit të policanit”**

HYRJE

1.1. Përfituesi /Autoriteti Kontraktues

Bashkia Polican

1.2. Historiku

Qyteti është ndërtuar në vitet '60 nga qeveria komuniste, qëllimi i së cilës ishte të krijonte një qytet industrial për prodhimin e armëve dhe municioneve.

Lindja e qytetit të Poliçanit ka mbetur e fiksuar në kujtesën e banorëve vendas, si qyteti që zbuti pasojat e krizës ekonomike të zonës dhe ushtrij ndikim të ndjeshëm në përmirësimin e gjendjes materiale dhe rritjen e nivelit të jetesës së saj. Poliçani ka qenë një fshat i vogël për t'u transformuar më vonë në një qytet industrial.

Në vitin 1961-1966 u kthye në një kантиer ndërtimi, me objektiv ngritjen e Uzinës Mekanike për prodhime ushtarake, që më vonë do të formonte Kombinatin Mekanik Ushtarak, i cili ndodhet në pjesën jugore të qytetit. Me fillimin e prodhimeve ushtarake, thithjen e një fuqie punëtorë të konsiderueshme nga disa rrethe të vendit, në vitin 1966-1967 u konsolidua qyteti i Poliçanit me një bazë të fuqishme të industrisë mekanike dhe asaj ushtarake. Ka qenë për një kohë të gjatë një qytet "fantazmë" rreth së cilit nuk dihej shumë, kjo për motive sigurie.

1.3. Situata Aktuale në Sektor

Infrastuktura e pamjaftueshme, e papërshtshme dhe e amortizuar për kryerjen e veprimtarive të përditshme.

Mungesa e veshjes së fasades së jashtme . Lënja e tyre me suva te thjeshte ose me tulla. Fasadat gjithashtu me kalimin e viteve kanë pësuar ndryshime nga banoret me ane të shtesave, carjeve te ndryshme për ndricim, restaurime individuale. Kjo gjë ka sjell një fasadë jo-uniforme, dhe që nuk përputhet me kushtet e efencës termike.

Degradimet e fasadës janë të ndara në dy lloje :degradime fizike, dhe degradime kimike.

Degradimet fizike : Këto janë krijuar nga faktori njeri. Këtu mund te futen degradimet si ndryshimi i materialit të përdorur ne fasad (si : laci tulla te ndryshme ,korniza gipsi, volume te ndryshme shtesë, materiale të ndryshme në përdorimin e fasadës, shkrime me boj ,etj.)

Degradime kimike : Këto degradime kanë të bëjnë me faktorët natyror, si ndryshimi i ngjyres së materialit, dëmtime, plasaritje, myku , kushtet atmosferike etj.

OBJEKTIVAT, QËLLIMI DHE REZULTATET E PRITURA

1.4. Objektivi i Përgjithshëm

Ky projekt synon evidentimin e problematikave që lindin nga mungesa e infrastrukturës fizike ,si dhe vleresimin e nevojave të tjera për të plotësuar maksimalisht standardet dhe normativat ligjore që parashikohen nga kuadri ligjor në fuqi. Krijimi i një fasade uniforme të të gjithë qytetit, si dhe rritja e performancës së efencës së enërgjisë.

1.5. Qëllimi

- 1. Krijimi i fasadave të qytetit sa më uniforme** –Duke prekur fasadat e qytetit me bojatisjen e tyre me ngjyra të përfaqëta me njëra-tjetrën. Ne bëjmë të mundur krijimin e një qyteti të rregullt estetikisht me një pamje të qartë dhe harmonike.Kështu bëjmë të mundur shmangjen e ndotjes vizuale të qytetit.
- 2. Përmirësim i kushteve energjike në ambient** – Duke e veshur të gjithë ambientin me polisterol(veshja kapote) si dhe duke e lyer ate.Bëjmë të mundur rritjen e efencës termike në ambient (duke mos pasur të mundur që energjia që është krijuar në ambjent të pësoj oshilacion termik)duke kaluar në një pjesë të energjis pasive të marrë nga banesat kolektive.
- 3. Krijimi i kushteve më të mira në lidhje me akustiken në ambiente** - Mbështjellja e objektit me veshjen me kapotë përpos ndihmon në efencën termike, ndihmon gjithashtu dhe në bllokimin e zërave të jashtëm në ambient.
- 4. Përforcimi i strukturës së jashtme të fasadës** – Para se të vishet fasada me veshjen kapot bëhet një veshje e fasadave të tullave dhe xokaturës së objektit për ti dhën godinës një robustitet më të madh.

5. **Krijimi i ambienteve më të përshtatshme për banim .**
6. **Godina të reja dhe cilësore .**
7. **Rikonstruksioni i tavanëve të objekteve të ndryshme.**

2. KËRKESAT FUNKSIONALE DHE TE PROJEKTIMIT

OBJEKTET

Të dhëna të përgjithshme dhe gjendja ekzistuese e objekteve

Objektet e destinuara për nderhyrje do të jenë kryesisht;

- ❖ Objekte kolektive banimi (2-6 kate),
- ❖ Rikonstrukcion pershtatje dhe permiresim i kushteve të objekteve ekzistuese,
- ❖ Ndertimi i fasadave sa më uniforme në të gjithë qytetin,
- ❖ Përmirësimi i cilësisë së ambienteve.

Projektuesi do të kryejë të gjithë punën në përputhje me standardet e projektimit dhe ndërtimit që janë në fuqi në Shqipëri, si dhe me një qasje sa më të mirë të normave të projektimit europiane.

3. Kërkesa mbi kondicionet konstruktive dhe funksionale

Në të gjitha godinat duhet të krijohen kushte komoditeti të përshtatshme me qëllim përmirësimin e fasadave të objekteve .

Mirëqënia dhe komforti

Projektet duhet të ofrojnë komfort termik në përputhje me kërkesat e mëposhtme:

- Ambientet e brendshme gjatë periudhës së verës:
 - Temperatura gjatë orarit të përdorimit duhet të jetë 24-26° C.
 - Lageshtia maksimale e lejuar duhet të jetë 50%.
- Ambientet e brendshme gjatë periudhës së Dimrit:
 - Temperatura e ambienteve të brendshme gjatë orarit të përdorimit duhet të jetë 21° C.
 - Temperatura e zonave të qarkullimit gjatë orarit të përdorimit duhet të jetë 15° C.
 - Lageshtia minimale e lejuar duhet të jetë 35%

Komodite termik dhe i lageshtisë së kërkuar arrihet duke përdorur një mënyrë të kombinuar të masave natyrore dhe masave artificiale (ose aktive).

Ne masat natyrore perfshihen elemente si orientimi i ndertesës, dimensionet e hapjeve etj.
Ne masat artificiale perfshihen elemente si termoizolimi i ndertesës dhe instalimin e impianeteve te Ngrohjes-Ftohjes qendrore dhe te ventilimit.

Standarti i izolimit

Izolimet duhet te jenë të një standarti të lartë. Ai duhet të projektohet per te rezistuar ne nje temperature kritike minimale (-12.6° C) dhe lageshtie relative te ajrit 40- 60%. Urat termike janë pika të dobëta termike të lokalizuara në mbulesën transmetuese termike të ndërtesës. Në krahasim me sipërfaqet e pashqetësuara të elementeve konstruktive, në këto pika ndodh një humbje e madhe termike nga brenda jashtë. Sa më i lartë standardi energjitik i një ndërtesë, aq me rëndësi është eliminimi i urave termike. **Shtresat e pllakave** Dyshemetë e tualeteve dhe muret e tyre në një lartësi të caktuar, duhet të izoloohen dhe projektuesi duhet të japë detajin e izolimit të tyre. Çdo shtresë duhet të jetë e detajuar me specififikimet përkatëse.

Pllakat e dyshemesë të jenë të tilla që të mos krijojnë rrëshqitje, dyshemeja të jetë e thatë, higjenike, e ngrohtë dhe e pastrueshme lehtësisht.

Konstruksioni

Mbulesat e objektit, me tarracë ose çati

Ne rastet kur do te perdoret mbulesa me cati me tjegulla duhet te kryhet termoizolimi me shtrese polisteroli prej 10cm e cila do te vendoset nen shtresen hidroizoluese ose nen strukturen e pjerret te catise. Dhoma e ajrit e krijuar midis catise dhe tavanit te varur do te permirsojë efencen termike te catise.

Në rastin e mbulesës me tarracë duhet te termoizolohet me shtrese polisteroli me densitet te larte (12cm) e pozicionuar midis shtreses me beton te varfer dhe shtreses hidroizoluese. Nese taraca eshte parashikuar te jete e shfrytezueshme duhet te meren te gjitha masat per mbrojtjen e shtreses hidroizoluese dhe termoizoluese.

Shtresa termoizoluese duhet te mos kete shkeputje nga elementet e tjere termoizolues ne mure dhe strukturat B/A per te shmangur krijimin e urave termike. Ne pjesen siperfaqesore te tarracave rekomandohet perdorimi i materialeve me ngjyre te hapur per te ulur sa me shume thithjen e rrezatimit diellor.

Projektuesi duhet të japë të gjitha detajet për shtresat e tarracës, vendosjen e kasetës së shkarkimit dhe ullukëve vertikalë- horizontalë. Në projektimin e ullukëve duhet të merret në konsideratë që të mos bllokohen nga faktorët e jashtëm. Gjithashtu projektuesi duhet të tregojë, numrin e ulluqeve dhe diametrat e tyre sipas normave në fuqi. Për sasi të reshjeve do të përdoren të dhënat e Institutit Hidrometeorologjik.

Dritaret dhe vetratat

Sipërfaqja e dritareve: Sipërfaqja e dritareve egzistuese të objekteve do të plotësohet me dritare të reja alumini dopjoxham. Këshillohet që të kemi kujdes kundrejt oshilacioneve

termike. Duke qenë se dritaret do të jene dopioxham, performaca e energjise ne ambient do të jetë e lartë.

Efiçenca Termike

Dritaret dhe vetratat duhet të jenë prej alumini me fuge termike ne strukturen e tyre. Te gjitha bashkimet duhet te jene te hidroizoluara dhe te bashkuara me termoizolim e fasades per te mos lejuar ura termike. Davancalet e dritareve qe do te perdoren duhet te jene te termoizoluara.

Xhami i perdorur duhet te jete transparent, me dy shtresa dhe te mbushura ne hapsiren midis tyre me gaz me eficence te larte energjitike.

Muret dhe strukturat mbajtese

Te gjitha fasadat duhet te vishen me termoizolim me sistem “Kapot” i realizuar me polisterol me densitet te larte (10cm). Shtresa termoizoluese e fasades do te fiksohet me kapse dhe me ngjitje ne elementet strukture dhe ne muraturen e tulles se nderteses. Shtresa perfundimtare e fasades do te percaktohet ne perputhje me specifikimit e kapitullit perkates ku percaktohet materializimi i fasadave. Kujdes i vecant duhet te tregohet per te evituar urat termike ne pjeset ku termoizolimi i fasades bashkohet me elementet e tjere te termoizoluuar si tarraca,

Kangjellat

Persa i përket kangjellave egzistuese të objektiveve , ato do të lyhen me bojë vaji për kangjellat , në përputhje me vizatimet teknike si dhe në bazë të kodeve të përcaktuara.

5. Llogaritjet, specifikimet teknike dhe preventivi

Kosto totale do të përcaktohet nga preventivi përfundimtar i objektit, që do të përgatitet bazuar në projektin e zbatimit, specifikimeve teknike, relacionin, si dhe duke marrë parasysh dhe kërkesat e veçanta të Bashkisë në lidhje me standardet e pranuar.

Në hartimin e preventivit çmimet e referencës do të jenë sipas legjislacionit në fuqi, mbështetur në Manualin Teknik të Çmimeve VKM nr. 627, datë 15.09.2015. Për zërat e punimeve që nuk gjenden në manual, projektuesi duhet të hartojë analiza përkatëse, të cilat do ti bashkëlidhen të detajuara projekt zbatimit, kjo për të siguruar kursimin dhe efiçencën e përdorimit të fondeve.

Preventivi do të paraqitet sipas Formatit/ Modelit të rekomanduar nga Bashkia.

6. Realizimi i Projektit

Projektet duke te realizohen duke ju referuar VKM Nr. 354, datë 11.5.2016 “Për Miratimin e Manualit të Tarifave për Shërbime në Planifikim Territori, Projektim, Mbikqyrje dhe Kolaudim”, duhet të kalojë në këto faza:

FAZA I Analiza e detyrës së projektimit

Analiza e detyrës së projektimit/ termave te referencës dhe përcaktimi i bazës së projektit. Gjetja e kushteve për zgjidhjen e detyrës nëpërmjet planifikimit. Ajo duhet të përfshijë një analizë të argumentuar të çështjeve/ kërkesave kryesore të trajtuara në detyrën e projektimit.

FAZA II Projekt ide paraprake (Përgatitja e projektit dhe planifikimit)

Përpunimi i pjesëve të rëndësishme të një zgjidhjeje të detyrës së planifikimit, e cila do paraqitet në jo më pak se 2 variant- propozime.

FAZA III Projekt ide përfundimtare (planifikimi i sistemimit dhe i integritimit)

Përpunimi i zgjidhjes përfundimtare të detyrës së planifikimit.

Pas miratimit në Këshill Teknik të variantit socio- ekonomik dhe teknik më të përshtatshëm të miratuar në fazën e projekt idesë paraprake, procedohet me projekt- idenë përfundimtare e cila do te permbaje te gjithë raportet dhe perllogaritjet e kesaj faze me qellim vleresimin para përfundimtar te konditave dhe kushteve te zhvillimit te projektit.

FAZA IV: Projekti për miratimin e lejes së ndërtimit: Përpunimi dhe dorëzimi i dokumentave për procedurat e nevojshme juridike e ligjore.

Projektuesi gjithashtu duhet të parashikojë dhe projektin për miratimin e lejes së ndërtimit, i cili duhet të mbështetet në ligjin nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”.

Për këtë për çdo dokumentacion të nevojshëm për hartimin e projektit si dhe për aplikimin për leje ndërtimi përmes portalit të Regjistrimit të Integruar të Territorit, të bashkëpunohet me Drejtorinë përkatëse të Bashkisë Tiranë.

FAZA V: Projekti zbatimi: Përpunimi dhe paraqitja e planit të zgjidhjes së gatshme për zbatim.

Dosja e plotë e projektit të zbatimit për cdo objekt duhet të përmbajë:

Raportet teknike Planvendosjen e objektit

Planimetritë

Rilevimin topografik

Projektin arkitektonik

Specifikimet teknike për zërat e punimeve që do të kryhen;

Preventivin e punimeve mbështetur në manualet teknike të çmimeve në fuqi;

Grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të punës;

Plan organizimin e punimeve dhe ngritjen e kantierit në funksion të mjeteve, që do të jenë pjesë e realizimit të objektit, mbështetur dhe në grafikun e punimeve;

FAZA VI: Hartimi i preventivit përfundimtar

Për hartimin e preventivit projektuesi duhet të mbështetet në VKM NR. 629, datët. 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”. Për secilin zë punimi, i cili nuk është i përfshirë në këtë manual, projektuesi duhet të dorëzojë analizat/ ofertat përkatëse të çmimeve.

Në hartimin e preventivit, veç të tjerave do të mbahen parasysh sa më lart, lidhur me organizmin e zbatimit me faza, çmimet e referencës sipas akteve ligjore në fuqi, dhe llogaritja e preventivit do të bëhet sipas normave dhe akteve ligjore në fuqi për të siguruar kursimin dhe efikasitetin e përdorimit të fondeve.

Preventivi do të përpilohet sipas formatit/ modelit standart të rekomanduar nga Bashkia Polican .

7. Rekomandime për projektuesin

Projektuesi duhet të përdorë dhe të rishikojë të gjithë informacionin ekzistues lidhur me zonën ku ndodhen objektet subjekt te projekteve, sistemin ekzistues të largimit të ujërave, sistemin e furnizimit të zonës me ujë të pijshëm, distancat e lejuara si dhe kriteret urbane të zonës në fjalë.

Standarde në Projektim

Projekti do të hartohet në përputhje me të gjitha normat dhe standardet për projektim që parashikon legjislativi në fuqi. Projektimi duhet të sigurojë respektimin e standardeve, madje edhe atyre gjatë zbatimit. Është përgjegjësi e projektuesit saktësia dhe respektimi i të gjitha standardeve dhe normave përkatëse.

Projektuesi mund të rekomandojë edhe prezantimin e standardeve të reja, për përafrimin me normat e BE-se, si dhe të praktikave më të mira ndërkombëtare në projektim dhe zbatim.

Në hartimin e projektit të mbahen parasysh normat e miratuara për personat me aftësi të kufizuar, të verbrit, etj. Në projekt të parashikohet infrastruktura e nevojshme për këtë kategori.

Detajet teknike të infrastrukturës për këtë kategori, të jepen nga projektuesi në Fletë të veçanta të Projektit.

Standarde në paraqitjen e dokumentacionit teknik

Në hartimin dhe paraqitjen e dokumentacionit të projektit, projektuesi të përdorë programet e kërkuara kompjuterike, si dhe të nxitet përdorimi i programeve të reja, më të avancuara të fushës.

Dorëzimi

Dorëzimi i tyre do të bëhet në rrugë zyrtare shoqëruar me liste dokumentash. Ato duhet të jenë të firmosura nga projektuesi.

Materiali grafik duhet të jetë në format A3 (3 kopje).

Vizatimet në formë dixhitale të jenë file .ACAD (“vizatim.dwg”).

Raportet teknike të çdo studimi si dhe raporti teknik përmbledhës në format A4 (3 kopje).

I gjithë materiali duhet të paraqitet në 3 kopje (hard copy & cd).

Ne CD 1 kopje e të gjithë materialit të jete format pdf dhe format të editueshem dwg.

Menaxhimi i Projektit

Autoriteti përgjegjës për menaxhimin e projektit është Bashkia Polican me stukturat e saj përkatëse.

Koha e përgatitjes së projektit

Për realizimin e këtij projekti duhet afati kohor si më poshtë:

Projekt Ideja do të dorëzohet 15 dite nga data e nënshkrimit të kontratës midis Bashkisë Polican dhe Konsulentit.

Projekt Zbatimi do të dorëzohet 45 dite nga miratimi i Projekt Idese nga ana e Autoritetit Kontraktor apo institucioneve të tjera kompetente.

*Koha që do të nevojitet për miratimet e fazave të projektit nga institucionet përkatëse nuk do të përfshihet në kohën e përgatitjes së projektit nga ana e konsulentit.

Oponenca teknike

- Mbas hartimit të kësaj faze (projekt-zbatimit) dokumentacioni do të nënshikohet opionences teknike bazuar në V.K.M. Nr.363, dt.18.07.2002 “Për vendosjen e opionences teknike për projektet e ndërtimit të objekteve”.

➤ **DETYRE PROJEKTIMI : “Ndërtimi i Parkimit Nëntokësor dhe hapësirës Rekreative”**

HYRJE

2.1. Përfituesi /Autoriteti Kontraktues

Bashkia Polican

2.2. Historiku

Qyteti është ndërtuar në vitet '60 nga qeveria komuniste, qëllimi i së cilës ishte të krijonte një qytet industrial për prodhimin e armëve dhe municioneve. Qyteti është ndërtuar në vitet '60 (1960) nga qeveria komuniste, qëllimi i së cilës ishte të krijonte një qytet industrial për prodhimin e armëve dhe municioneve. Lindja e qytetit të Poliçanit ka mbetur e fiksuar në kujtesën e banorëve vendas, si qyteti që zbuti pasojat e krizës ekonomike të zonës dhe ushroj ndikim të ndjeshëm në përmirësimin e gjendjes materiale dhe rritjen e nivelit të jetesës së saj. Poliçani ka qenë një fshat i vogël për t'u transformuar më vonë në një

qytet industrial. Në vitin 1961-1966 u kthye në një kantier ndërtimi, me objektiv ngritjen e Uzinës Mekanike për prodhime ushtarake, që më vonë do të formonte Kombinatit Mekanik Ushtarak, i cili ndodhet në pjesën jugore të qytetit. Me fillimin e prodhimeve ushtarake, thithjen e një fuqie punëtorë të konsiderueshme nga disa rrethe të vendit, në vitin 1966-1967 u konsolidua qyteti i Poliçanit me një bazë të fuqishme të industrisë mekanike dhe asaj ushtarake.

Ka qenë për një kohë të gjatë një qytet "fantazmë" rreth së cilit nuk dihej shumë, kjo për motive sigurie.

2.3. Situata Aktuale në Sektor

Infrastuktura është e amortizuar dhe e pamjaftueshme për automjetet si dhe për kembesoret. Gjë që bën të mundur një vështirësi për qytetarët që të lëvizin në zonë. Mungesa e një terminali për autobuzat, parkimin e automjeteve etj. Një problem tjetër në lidhje me zonën ka të bëjë dhe me mungesën e një hapësirë tregtare ushqimore , rekreative, kulturore për banorët por, dhe për turistët e vendit. Këto problematika që pasqyrojmë , me anë të një plani arkitektonik mund të zgjidhen në një mënyrë sa më efikase, duke polotësuar kërkesat dhe nevojat e qytetarëve .

OBJEKTIVAT, QËLLIMI DHE REZULTATET E PRITURA

2.4. Objektivi i Përgjithshëm

Ky projekt synon evidentimin e problematikave që lindin nga mungesa e infrastrukturës fizike ,si dhe vlerësimin e nevojave të tjera për të plotësuar maksimalisht standardet dhe normativat ligjore që parashikohen nga kuadri ligjor në fuqi. Krijimi i një hapësire për shërbimet e nevojshme të qytetarëve si : vendparkim, terminal, tregtia ushqimore si dhe hapësirë rekreative .

2.5. Qëllimi

- 8. Mjedise dhe infrastrukturë e re sipas standarteve për veprimtarinë rekreative të qytetarëve -** Krijimi i një hapësire të përshtatshme për qytetarë për të kryer aktivitetet e perditshme si tregtia ushqimore, relaksi, parkimi i makinave si dhe një pikë për terminalët.
- 9. Përmirësimi i infrastrukturës së zonës –** me anë të krijimit të një hapësire parkimi , i japim mundësinë qytetarëve të kenë më shumë hapësira parkimi dhe të mos ketë probleme me trafikun e tij.
- 10. Rivitalizim i ambienteve rekreative e clodhëse-** Rikonceptimin dhe rivitalizimin e ambienteve rekreative dhe clodhëse për qytetarët synon të ketë impakt të konsiderueshëm në përmirësimin e jetesës së tyre.

11. **Kriimi i një hapësire të përshtatshme tregtare** – Mungesa e një hapësire tregtare ishte evidentuar në qytet, me anë të riprojektimit të tij, bejme të mundur krijimin e një hapësire të përshtatshme për tregtinë ushqimore të zonës.
12. **Hapësira rekreative dhe kulturore.**
13. **Sheshe të reja dhe cilësore .**

3. KËRKESAT FUNKSIONALE DHE TE PROJEKTIMIT

OBJEKTET

Të dhëna të përgjithshme dhe gjendja ekzistuese e objekteve

Zona e destinuar për ndërhyrje do të jetë ;

- ❖ Sheshi qendror në hyrje të qytetit ,
- ❖ Ndërtimi i një hapësire parkimi nëntokësore ,
- ❖ Krijimi i një hapësirë tregtare ,

Kërkesa projektimi të përgjithshme për ndërtimin e godinave

Projektuesi do të kryejë të gjithë punën në përputhje me standardet e projektimit dhe ndërtimit që janë në fuqi në Shqipëri, si dhe me një qasje sa më të mirë të normave të projektimit europiane.

Funksionaliteti

Gjatë projektimit të ndërtesës do të krijohet një bilanc mes cilësisë së funksionimit dhe efikasitetit të kostos. Ky bilanc mund të arrihet me mjete të ndryshme, siç janë:

Dimensionet racionale të hapësirave:

- a) Zonat e përshtatura të qarkullimit
- b) Zonat e përshtatura për ambiente teknike
- c) Zonat e përshtatura për poste makinash
- d) Poste makinash për persona me aftësi të kufizuara
- e) Integrimi i nevojave të tjera të domosdoshme

3. Kërkesa mbi kondicionet konstruktive dhe funksionale

Në të gjithë ambientet e parkimit nëntokësor duhet të krijohen kushte komoditeti të përshtatshme .

Faktorët mesatarë për reflektimin e dritës

Ndriçimit duhet t'i kushtohet shumë rëndësi për çdo zonë veprimtarie pasi është element kyç për të krijuar një ambient sa më të ngrohtë. Në dhomat me ndriçim të varfër natyral lejohet një maksimum prej 500 lx. Dhomat që nuk kanë dritare në tavan apo dritare të jashtme, duhet të pajisen me tuba përcjellës së dritës natyrale.

Sistemi i ndricimit

Gjatë projektimit duhet patur parasysh që ky sistem do të përfshijë sa më qartë :

- Skemat e ndricimit normal
- Skemat e ndricimit emergjent
- Skemat e ndricimit të evakuimit (Sinjalizimit)

Skema e tokëzimit

Gjatë projektimit të skemës së tokëzimit duhet të merret parasysh që të studiohen mirë elementet si sigma e tokës, lloji i tokës, lageshtia e saj me qellim që gjatë kalkulimit rezistenca perfundimtare të jetë më e vogël ose e barabartë me 4Ω .

Sistemi i rrufepritësit

Ndërtesa duhet patjetër të kenë sistemin e mbrojtjes atmosferike pasi Shqipëria gjendet në një zonë me shkarkime atmosferike të shumta.

Sistemi i mbrojtjes atmosferike duhet të bëhet duke u bazuar në kushtet teknike të përcaktuara dhe në specifikimet e materialeve të ndërtimit.

Standarti i izolimit

Izolimet duhet të jenë të një standarti të lartë. Ai duhet të projektohet për të rezistuar në një temperaturë kritike minimale (-12.6°C) dhe lageshtie relative të ajrit 40- 60%. Urat termike janë pika të dobëta termike të lokalizuara në mbulesën transmetuese termike të ndërtesës. Në krahasim me sipërfaqet e pashqetësuara të elementeve konstruktive, në këto pika ndodh një humbje e madhe termike nga brenda jashtë. Sa më i lartë standarti energjitik i një ndërtese, aq më rëndësi është eliminimi i urave termike. Këshillohet që gjatë projektimit të mënjanohej strukturat me shumë degëzime dhe të vendosen ndarje termike të elementeve konstruktive konsol (pllakat e ballkonit, kollonat, konsolat mbajtëse) me strukturat në kufi;

Shtresat e pllakave

Dyshemetë e tualeteve dhe muret e tyre në një lartësi të caktuar, duhet të izolohej dhe projektuesi duhet të japë detajin e izolimit të tyre. Çdo shtresë duhet të jetë e detajuar me specifikimet përkatëse.

Pllakat e dyshemesë të jenë të tilla që të mos krijojnë rrëshqitje, dyshemeja të jetë e thatë, higjienike, e ngrohtë dhe e pastrueshme lehtësisht.

Konstruksioni

Standartet referuese për projektin konstruktiv

Eurocodet

- EC0 Bazat e projektimit të strukturave
- EC1 Ngarkesat në struktura
- EC2 Projektimi i strukturave b/a
- EC7 Projektimi gjeoteknik
- EC8 Projektimi sizmik i strukturave.

Dhe të gjithë anekset e tjera EN sipas nevojave të projektimit për çdo rast

Kushtet shqiptare të projektimit dhe konkretisht

- Kushtet teknike të projektimit KTP -1978
- Kushtet teknike të projektimit për ndërtimet antisizmike KTP-N.2-89

Projektimi duhet të bazohet në standartet e projektimit të strukturave, dhe mqs në vendin tonë janë akoma në fuqi Kushtet teknike të projektimit të vitit 1978 -1979, të cilat nuk pasqyrojnë zhvillimet dhe normat e fundit të hartuara për këtë qëllim, rekomandojmë që projektimi të bëhet duke u mbështetur edhe në normat e Eurocodeve.

Përpara hartimit të projektit duhet të bëhet studim gjeologjik dhe sizmik për terrenin në të cilin ndërtohet objekti. Studimi sizmik i detajuar duhet paraqitur në flete të vecanta të projektit.

Sugjerojmë që projektimi i godinave pjesë të katër termave referencë të bëhet me struktura b/a, dhe marka e betonit të përdorur të mos jetë më e vogël se C25/30, ndërsa çeliku i përdorur të jetë i markës S500 (sidenor) ose ekuivalent me të p.sh FeB44k). Gjithashtu rekomandojmë që themelet të jenë pllaka b/a, të hidroizoluara nga jashtë. Soletat e ndërkateve të jenë soleta monolite, me trarë të thellë.

Sistemi i Ventilimit

Sistemi i Ventilimit duhet të projektohet në mënyrë që të arrihet të plotësojë qëllimet kryesore si:

- Duhet të arrihet të plotësojë kërkesën për ventilim dhe furnizim me ajër të freskët për nevojat e frymshkembimit të personave që do përdorin këto ambiente.
- Duhet të sigurojë largimin e ndotesve dhe aromat e keqja nga ambientet duke bërë të mundur permiresimin e cilësive së ajrit. Mundësisht të rregullojë dhe përqendrimin e lageshtitise të ajrit në ambiente.
- Permiresimin e komfortit termik duke ruajtur regjimin termik të impianteve të ngrohjes/ftohjes.

Impianti i ventilimit është i domosdoshëm për qëllimin e ajrit të ambienteve vecanerisht kur këto ambiente mbipopullohen.

Tipet e impiantit të ventilimit janë :

- Ventilim Natyral
- Ventilim Mekanik

Perzgjedhja e tipologjisë së sistemit duhet të bëhet në mënyrë të kujdesshme dhe duke analizuar një sërë faktorësh që kanë të bëjnë me klimën e zonës në të cilën objekti është i vendosur si dhe arkitektura e objektit.

Ventilimi natyral

Ventilimi natyral nënkupton futjen e ajrit të jashtëm nëpërmjet hapësirave fikse ose pjesëve të hapëshme si dritare ose dyer që lidhen direkt me ambientin e jashtëm.

Nëse ventilimi natyral është i papërshtatshëm ose i pamjaftueshëm për të arritur parametrat e kërkuar të nevojshëm të ambientit atëherë në këto raste duhet të aplikohet ventilim mekanik.

Ventilimi mekanik

Ventilimi mekanik është metoda e transferimit të ajrit të freskët në ambientet e brendshme duke përdorur një sistem ventilatorësh dhe kanale ajri në mënyrë që të fitohet ndërrimi i sasisë së ajrit të nevojshëm për të fituar një ambient me parametra të kënaqshëm për zhvillimin normal të aktivitetit.

Sistemi i ventilimit mekanik duhet të projektohet duke pasur parasysh që të sigurojë:

- a. Shpërndarje të rregullt të ajrit.
- b. Nivel zhurme të ulët.
- c. Një operim me kosto të ulët.
- d. Një filtrim të mirë të ajrit.

Projekti i plotë i mbrojtjes kundër zjarrit dhe shpëtimit (MKZSH)

Projektuesi duhet të paraqesë dhe projektin e mbrojtjes nga zjarri si dhe rregullat e sigurimit teknik për MNZ sipas normave dhe standardeve evropiane. Ky impiant përfshin tërësinë e masave arkitektonike, konstruktive, mekanike dhe elektrike për “Parandalimin, mbrojtjen dhe ndërtimin e Impianteve të Mbrojtjes Kundër Zjarrit”.

Këto masa sipas funksionit dhe mënyrës së aplikimit ndahen në masa të “Mbrojtjes Pasive” dhe në masa të “Mbrojtjes Aktive”.

Sistemi i lajmërimit për zjarrin

Ndërtesa duhet të ketë gjithashtu sistemin e brendshëm të alarmit, nëpërmjet të cilit në rast rreziku të bëhet largimi nga ndërtesa.

Sinjali i alarmit duhet të transmetohet në të gjitha ambientet e brendshme dhe të jetë i qartë dhe i kuptueshëm nga të gjithë.

Sistemi i alarmit duhet të futet në punë pavarësisht nga furnizimi me energji elektrike i objektit.

Ndriçimi i emergjencës duhet të futet automatikisht në punë dhe të ketë një kohë pune të paktën 1 orë në rast se stakohet tensioni. Ndriçimi i emergjencës dhe i sigurisë duhet të vendoset në ambientet e mëposhtme:

- Korridore, të cilat shërbejnë edhe si rrugë largimi emergjence;
- Dhoma që shërbejnë si salla mbledhësh;
- Në ambientet që nuk kanë dritare;
- Në të gjitha dhomat e furnizimit me energji (gas, elektricitet etj).

Sinjalizuesit e tymit

Këto do të veprojnë në mënyrë që të mbajnë ekuilibrin ndërmjet dhomës së hapur dhe të mbyllur, kështu kur tymi depërton në dhomën e hapur ai do të ketë kontakt me qarkun dhe do të aktivizojë sinjalin.

Të gjithë sinjalizuesit e tymit, të jenë instaluar të tilla që të mund të zëvendësohen.

Bombulat fikëse të zjarrit

Bombulat fikëse (me shkumë ose pluhur) duhet të vendosen në korridore dhe në ambientin teknik.

Kalimet e emergjencës, shkallët, koridoret

Numri dhe gjerësia e kalimeve të emergjencës duhet të sigurojnë largimin sa më të shpejtë dhe shfrytëzimi i tyre të nxjerrë në vend të sigurt jashtë ndërtesës me një rrugë të shkurtër, të shpejtë dhe pa rrezik. Për përcaktimin e gjerësisë dhe gjatësisë së rrugëve të emergjencës, faktori kryesor është kohëzgjatja e largimit të personave nga objekti. Koha maksimale e largimit nga objekti në sekonda për çdo dhomë, mbas dhënies së sinjalit të alarmit duhet të jepet e llogaritur nga projektuesi.

Lidhja me autopompën është një paisje që ndihmon në shuarjen e zjarrit e lidhur me rrjetin hidrik nëpërmjet të cilës mund të sigurohet ujë për rrjetin hidrik në rast emergjence zjarri.

Ambientet komunikuese, hyrjet, shkallët, korridoret, hollet

Të gjitha kategoritë e ndërtesave arsimore kanë nevojë për ambiente komunikuese, hyrje, holl, korridore, shkallët, rampat, parrakë për shkallët.

Hyrjet në godinë duhen projektuar të tilla që të mundësojnë hyrje - dalje të lirshme të nxënësve.. Për çdo hyrje për në shkollë duhet të projektohet nënstreha.

Në çdo kat duhet të ketë së paku një dalje emergjente, në distanca sa më të mëdha nga shkalla kryesore.

Projekti i plotë i ujësjellësit

Furnizimi me ujë të ftohte sanitar është i domosdoshëm për zhvillimin normal të aktivitetit mësimor.

Furnizimi me ujë i mjediseve arsimore mund të kryhet nga rrjeti urban ose prej puseve në rastet kur rrjeti urban nuk garanton nevojat për ujë të këtyre ambienteve. Në bashkëpunim me

shoqërinë e Ujësjetllës-Kanalizime sh.a. do saktësohet dhe gjendja e ujësjetllësit ekzistues të zonës si dhe problemet e vërejtura në këtë zonë gjatë periudhës së furnizimit me ujë duke përcaktuar edhe kapacitetin depozitues për furnizim me ujë të rrjedhshëm pa ndërprerje gjatë ditës.

Projektuesi të parashikojë ne projekt/preventivin e objektit, vlerën e furnizimit dhe vendosjes së linjës së furnizimit me ujë nga pika e marrjes së dhënë nga Ujësjetllës –Kanalizime sh.a Tiranë deri tek matësi i ujit.

Impianti i furnizimit me ujë të ngrohtë sanitar

Uji i ngrohte sanitar duhet përgatitur me sistem panelesh diellore për uje te ngrohte, ku duhet marre parasysh se paku 1 m2 panel diellor për cdo 100 litra uje te ngrohte ne dite.

Projekti i plotë i kanalizimeve

Sistemi i shkarkimit të ujrave në tërësinë e tij përmban rrjetin e mbledhjes së ujrave atmosferike, ujrave të zeza, ujrave gri dhe ujrave me përmbajtje yndyrore.

Të merret në konsideratë perspektiva e rritjes së numrit të studentëve. Të merret në konsideratë rrjeti ekzistues i kanalizimeve të zonës ku do të ndërtohet objekti, por gjithashtu konsulentit duhet të marrë në konsideratë projektin e ri të kanalizimeve për këto zona (nqse janë përgatitur).

Për orientim, sasi të e ujërave të zeza që derdhen në sistemin e kanalizimeve të qytetit të Tiranës të përdorura për projektimin e rrjetit të kanalizimeve janë si më poshtë:

$Q_{mes\ dit} = 194\ l/ditë/banorë$

$Q_{max\ or} = 437\ l/ditë/banorë$

Në përputhje me normat, konsulentit duhet të ketë parasysh numrin e studenteve, stafit mësimor dhe administrativ. Materiale plastike nuk do të përdoren në projekt (psh kanal kullimi, ulluk shiu, tubacion, pjesët e brendëshme të ëc-ve, etj), përveç se në rastet kur rekomandohet nga konsulentit se është materiali më i mirë që mund të përdoret për këtë qëllim.

Rrjeti i shkarkimit të ujërave të zeza do të ndërtohet me materiale bashkëkohore dhe në përputhje me standartet në fuqi.

4. Kërkesa të veçanta

Nevojat për Personat me Aftësi të Kufizuara duhet të kenë një vëmendje të veçantë gjatë projektimit të ndërtesave. Këtyre personave duhet të mundësohet akses në të gjitha ambientet e përbashkëta, auditoret, laboratorët, seksionet e administratës pedagogjike etj. Për të arritur këto qëllime ndehyrja duhet të parashikojë heqjen e të gjitha barrierave arkitektonike duke parashikuar rampa dhe ashensore që mundësojnë akses në cdo ambient.


Në projekt zbatimi duhet të jepet zgjidhja hapësinore dhe e formës me të cilin sigurohet përshatja e PAK në hapësirat e ndërtesave të destinuar për lëvizje, qëndrim ose punë. Ky

problem kerkon dimensionim te vecante te zonave te qarkullimit, hapsirave te dyerve, pajisjeve sanitare, shtigjeve te evakuimit dhe hapsirave te ambienteve per te akomoduar personat me nevoja te vecanta. Kalimet duhet te sigurojne levizje me karroce per PAK me sipërfaqe minimale rrethore me dimeter 150cm

Gjate projektimit duhet te krijohet nje njohje adeguate e te dhenave antropometrike dhe ne pergjithesi e “kinosferes” se personave me aftesi te kufizuara ne menyre qe te sigurohet integrimi real dhe plotesimi i nevojave te ketij grupi te vecante perdoruesish.

Karrocat e invalideve kane dimensione te ndyshme ne varesi te moshes dhe markes se prodhuesit te artikullit. Megjithate dimensionet mesatare qe duhet te merren parasysh jane si meposhteme:

- Gjerësia e karriges përgjithësisht është mes 600 dhe 700 mm
- Gjatësia është mes 1000 dhe 1250 mm
- Rrezja e jashtme është mes 1300 dhe 1500 mm



Perjashtim nga detyrimi per pershtatje mund te kryhet vetem per ndertesat me vlera kulturore. Ne kete rast do te kryhen nderhyje qe facilitojne perdorimin dhe aksesin nga PAK por qe nuk cenojne vlerat e godines. Ne cdo rast duhet te merret aprovimi perkates nga ministrите perkatese.

Ashensori

Ashensori do të shërbejë për lëvizjen vertikale të personave me aftësi të kufizuar apo në raste të tjera të domosdoshme ne rast se nuk ka zgjidhje teknike tjeter. Ai duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:


- Gjerësia minimale e derës së ashensorit: 85 cm
- Tubat mbajtës dhe paneli i komandimit të ashensorit jo më lart se 90 cm
- Dimensioi i hapësires së brendshme të ashensorit, jo më pak se 1 m x 1.4 m

Gjithashtu do te kihet ne konsiderate normative europiane per personat me aftesi te kufizuar per te cilat do te kushtohet nje vemendje e vecante nga projektuesi, kjo ne bashkepunim te ngushte dhe me stafin e Bashkise Tirane.

Rampat

Eshte e sygjerueshme qe projekti i nderteses te konceptohet ne menyre te tille qe te shmanget sa me shume te jete e mundur perdorimi i rampave. Nese nje situatë te tille eshte e pashmangshme, dhe rampat duhet te sigurojne akses ne te gjithe ambientet e paaksesueshme

nga PAK. Gjeresia minimale e rampave duhet te jete 90cm dhe pjerrtesia maksimale nuk duhet te kaloje 5%.



Tualetet

Ne cdo godine duhet te parashikohet te pakten 1 ëc e pershtatur per PAK me qellim plotesimin e kushteve sanitare. Shërbimet higjenike duhet te garantojne manovrim dhe perdorimin e pajisjeve. Tek ëc duhet te kete afrim anesor te pakten 100cm dhe afrim ballor tek lavamani. Gjithashtu duhet te parashikohet instalimi i parmakeve prane ëc-ve ne lartesi 80cm dhe me diameter 3-4cm.

5. Llogaritjet, specifikimet teknike dhe preventivi

Kosto totale do të përcaktohet nga preventivi përfundimtar i objektit, që do të përgatitet bazuar në projektin e zbatimit, specifikimeve teknike, relacionin, si dhe duke marrë parasysh dhe kërkesat e veçanta të Bashkisë në lidhje me standardet e pranuar.

Në hartimin e preventivit çmimet e referencës do të jenë sipas legjislacionit në fuqi, mbështetur në Manualin Teknik të Çmimeve VKM nr. 627, datë 15.09.2015. Për zërat e punimeve që nuk gjenden në manual, projektuesi duhet të hartojë analiza përkatëse, të cilat do të bashkëlidhen të detajuara projekt zbatimit, kjo për të siguruar kursimin dhe efëçencën e përdorimit të fondeve.

Preventivi do të paraqitet sipas Formatit/ Modelit të rekomanduar nga Bashkia.

6. Realizimi i Projektit

Projektet duke te realizohen duke ju referuar VKM Nr. 354, datë 11.5.2016 “Për Miratimin e Manualit të Tarifave për Shërbime në Planifikim Teritori, Projektim, Mbikqyrje dhe Kolaudim”, duhet të kalojë në këto faza:

FAZA I Analiza e detyrës së projektimit

Analiza e detyrës së projektimit/ termave te referencës dhe përcaktimi i bazës së projektit. Gjetja e kushteve për zgjidhjen e detyrës nëpërmjet planifikimit. Ajo duhet të përfshijë një analizë të argumentuar të çështjeve/ kërkesave kryesore të trajtuara në detyrën e projektimit.

FAZA II Projekt ide paraprake (Përgatitja e projektit dhe planifikimit)

Përpunimi i pjesëve të rëndësishme të një zgjidhjeje të detyrës së planifikimit, e cila do paraqitet në jo më pak se 2 variant- propozime.

FAZA III Projekt ide përfundimtare (planifikimi i sistemimit dhe i integritimit)

Përpunimi i zgjidhjes përfundimtare të detyrës së planifikimit.

Pas miratimit në Këshill Teknik të variantit socio- ekonomik dhe teknik më të përshtatshëm të miratuar në fazën e projekt idesë paraprake, procedohet me projekt- idenë përfundimtare e cila do të përmbaje të gjithë raportet dhe perlllogaritjet e kesaj faze me qellim vleresimin para përfundimtar të konditave dhe kushteve të zhvillimit të projektit.

FAZA IV: Projekti për miratimin e lejes së ndërtimit: Përpunimi dhe dorëzimi i dokumentave për procedurat e nevojshme juridike e ligjore.

Projektuesi gjithashtu duhet të parashikojë dhe projektin për miratimin e lejes së ndërtimit, i cili duhet të mbështetet në ligjin nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”. Për këtë për çdo dokumentacion të nevojshëm për hartimin e projektit si dhe për aplikimin për leje ndërtimi përmes portalit të Regjistrimit të Integruar të Territorit, të bashkëpunohet me Drejtorinë përkatëse të Bashkisë Tiranë.

FAZA V: Projekti zbatimi: Përpunimi dhe paraqitja e planit të zgjidhjes së gatshme për zbatim.

Dosja e plotë e projektit të zbatimit për cdo objekt duhet të përmbajë:

Raportet teknike Planvendosjen e objektit

Planimetritë

Rilevimin topografik

Projektin arkitektonik

Specifikimet teknike për zërat e punimeve që do të kryhen;

Preventivin e punimeve mbështetur në manualin teknike të çmimeve në fuqi;

Grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të punës;

Plan organizimin e punimeve dhe ngritjen e kantierit në funksion të mjeteve, që do të jenë pjesë e realizimit të objektit, mbështetur dhe në grafikun e punimeve;

FAZA VI: Hartimi i preventivit përfundimtar

Për hartimin e preventivit projektuesi duhet të mbështetet në VKM NR. 629, datët. 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”. Për secilin zë punimi, i cili nuk është i përfshirë në këtë manual, projektuesi duhet të dorëzojë analizat/ ofertat përkatëse të çmimeve.

Në hartimin e preventivit, veç të tjerave do të mbahen parasysh sa më lart, lidhur me organizimin e zbatimit me faza, çmimet e referencës sipas akteve ligjore në fuqi, dhe llogaritja e preventivit do të bëhet sipas normave dhe akteve ligjore në fuqi për të siguruar kursimin dhe efikasitetin e përdorimit të fondeve.

Preventivi do të përpilohet sipas formatit/modelit standart të rekomanduar nga Bashkia Polican.

7. Rekomandime për projektuesin

Projektuesi duhet të përdorë dhe të rishikojë të gjithë informacionin ekzistues lidhur me zonën ku ndodhen objektet subjekt te projekteve, sistemin ekzistues të largimit të ujërave, sistemin e furnizimit të zonës me ujë të pijshëm, distancat e lejuara si dhe kriteret urbane të zonës në fjalë.

Standarde në Projektim

Projekti do të hartohet në përputhje me të gjitha normat dhe standardet për projektim që parashikon legjislacioni në fuqi. Projektimi duhet të sigurojë respektimin e standardeve, madje edhe atyre gjatë zbatimit. Është përgjegjësi e projektuesit saktësia dhe respektimi i të gjitha standardeve dhe normave përkatëse.

Projektuesi mund të rekomandojë edhe prezantimin e standardeve të reja, për përafrimin me normat e BE-se, si dhe të praktikave më të mira ndërkombëtare në projektim dhe zbatim.

Në hartimin e projektit të mbahen parasysh normat e miratuara për personat me aftësi të kufizuar, të verbrit, etj. Në projekt të parashikohet infrastruktura e nevojshme për këtë kategori.

Detajet teknike të infrastrukturës për këtë kategori, të jepen nga projektuesi në Fletë të veçanta të Projektit.

Standarde në paraqitjen e dokumentacionit teknik

Në hartimin dhe paraqitjen e dokumentacionit të projektit, projektuesi të përdorë programet e kërkuara kompjuterike, si dhe të nxitet përdorimi i programeve të reja, më të avancuara të fushës.

Dorëzimi

Dorëzimi i tyre do të bëhet në rrugë zyrtare shoqëruar me liste dokumentash. Ato duhet të jenë të firmosura nga projektuesi.

Materiali grafik duhet të jetë në format A3 (3 kopje).

Vizatimet në formë dixhitale të jenë file .ACAD (“vizatim.dwg”).

Raportet teknike të çdo studimi si dhe raporti teknik përmbledhës në format A4 (3 kopje).

I gjithë materiali duhet të paraqitet në 3 kopje (hard copy & cd).

Ne CD 1 kopje e të gjithë materialit të jetë format pdf dhe format të editueshem dwg.

Menaxhimi i Projektit

Autoriteti përgjegjës për menaxhimin e projektit është Bashkia Polican me strukturat e saj përkatëse.

Koha e përgatitjes së projektit

Për realizimin e këtij projekti duhet afati kohor si më poshtë:

Projekt Ideja do të dorëzohet 15 dite nga data e nënshkrimit të kontratës midis Bashkise Polican dhe Konsulentit.

Projekt Zbatimi do të dorëzohet 45 dite nga miratimi i Projekt Idese nga ana e Autoritetit Kontraktor apo institucioneve të tjera kompetente.

*Koha që do të nevojitet për miratimet e fazave të projektit nga institucionet përkatëse nuk do të përshihet në kohën e përgatitjes së projektit nga ana e konsulentit.

Oponenca teknike

Mbas hartimit të kësaj faze (projekt-zbatimit) dokumentacioni do të nënshikohet opionences teknike bazuar në V.K.M. Nr.363, dt.18.07.2002 “Për vendosjen e opionences teknike për projektet e ndërtimit të objekteve”.

➤ **DETYRE PROJEKTIMI : “Transfetimi i Uzinës Mekanike Nr.1 (Tunelet) në Muze Historik”**

HYRJE

3.1. Përfituesi /Autoriteti Kontraktues

Bashkia Polican

3.2. Historiku

Kombinati Mekanik Polican është një ndërmarrje shtetërore, e themeluar në vitin 1962, me qëllim përmbushjen e kërkesave të Forcave të Armatosura Shqipëtare për armatim. Kombinati ndodhet pranë qytetit të Policanit, në rrethin e Skraparit, 22 km në jug të qytetit të Beratit. Uzina e Prodhimit të Municioneve (sot Kombinati Mekanik Polican), u ndërtua dhe filloi aktivitetin e saj në vitet 60-të.

Kombinati i armëve në Polican ishte baza mbi të cilën u ndërtua edhe qyteti i Policanit. Të gjithë banorët ishin në funksion të operacioneve të prodhimit të armëve dhe municioneve për ushtrinë e shtetit komunist.

Sipërfaqja e përgjithshme e Policanit është 600 ha. Nga këto, 58 ha është zonë urbane, kurse pjesa tjetër është e ndarë në pyje e toka bujqësore dhe 59 ha është sipërfaqja e Kombinatit Mekanik Polican.

Policani ka qenë një fshat i vogël për t’u transformuar më vonë në një qytet industrial. Në vitin 1961-1966 u kthye në një kantier ndërtimi, me objektiv ngritjen e Uzinës Mekanike për prodhime ushtarake, që më vonë do të përbënte Kombinatit Ushtarak. Me fillimin e prodhimeve ushtarake, thithja e një fuqie punëtore të konsiderueshme nga disa rrethe të vendit në vitin 1966-1967, solli konsolidimin e qytetit të Policanit me një bazë të fuqishme të industrisë mekanike dhe asaj ushtarake.

Ndërtimi i uzinës është nga të parat vepra ku u bë një punë e paimagjinueshme jo vetëm fizike por edhe shkencore. Uzina Mekanike u shndërrua në një shkollë për mësimin dhe përgatitjen e specialistëve dhe mjeshtrave të rrallë. Kjo uzinë “prodhoi” njerëz praktikë dhe dinjitozë, me një disiplinë të rreptë dhe korrektësi në punë.

Uzina filloi prodhimin e municioneve për herë të parë në vitin 1967. Në fillim, u vu në punë linja e prodhimit të fishekut 7.62 mm dhe më pas me radhë linjat e prodhimit të granatave të dorës ofensive dhe difensive, minave kundërtank e kundërkëmbësorisë, predhave të mortajave 82 mm, kapsollave detonatore KD 8, fishekzjarreve 180 mm etj.

Me kalimin e viteve, krahas prodhimit, vazhdoi në mënyrë të pandërprerë puna eksperimentuese për prodhimin e artikujve të tjerë të nevojshëm për ushtrinë. Në këtë proces eksperimentimi u përfshinë dhjetra inxhinierë dhe specialistë të aftë nga i gjithë vëndi. Si rezultat i kësaj pune, në vitet 80-të u vunë në punë linjat e prodhimit të predhave 60, 107 dhe 120 mm, djegoreve 60 dhe 82 mm, fishekëve bazë 60 dhe 120 mm, fishekëve 12.7, 14.5 dhe 9 mm, etj. Rritja e nomenklaturës së prodhimeve, kapaciteteve prodhuese dhe numrit të punonjësve, i cili arriti shifrën 3 200, ishin faktorët bazë që në vitin 1986 e shndërruan Uzinë në Kombinatin të Prodhimeve Ushtarake.

Aktualisht, në Kombinatin Mekanik Polican janë të instaluara 12 linja kryesore për prodhimin e artikujve të lartpërmendur. Cikli i punës është i mbyllur duke realizuar në kombinat prodhimet ushtarake, instrumentat dhe veglat e punës, deri në amballazhimin e prodhimit të gatshëm. Linjat e prodhimit janë të përbëra nga makineri speciale, të destinuara për prodhimin e municioneve. Vetëm 5 deri 10 % e kapaciteteve prodhuese kanë karakter universal dhe mund të përdoren për prodhime civile.

Mbas vitit 1992, si rrjedhojë e ristrukturimit të Ushtrisë dhe mungesës së fondeve, porositë për ushtrinë në Kombinatin Mekanik Polican u ulën në mënyrë drastike, duke sjellë si pasojë reduktimin e fuqisë punëtore nga 3 200 në 1 700. Gjatë viteve 1994 – 1997, prodhimi u ndërpre plotësisht.

Nga korriku 2006 e deri tani ndërmarja funksionon me pavarësi financiare nga shteti. Aktiviteti kryesor aktual është demilitarizimi i municioneve të tepërta të F.A. Sasia e municioneve të asgjësuar në Kombinatin që prej vitit 2001 e deri tani, është rreth 26 000 ton (municione të shtimjeve të topave 57 mm, 76 mm, 85 mm, 100 mm, bomba aviacioni 100 kg, 150 kg., 250 kg, predha mortaje 107 mm dhe 82 mm). Aktualisht po demilitarizohen municione mortaje 82 mm prodhim importi (rus, kinez), granatat e dorës dhe fishekë 7.62 mm.

Është fabrika që ka teknologjinë më të lartë ushtarake në vend dhe më e sigurta për sa i përket demontimit të armëve ushtarake.

3.3. Situata Aktuale në Sektor

Infrastuktura është e amortizuar dhe e pamjaftueshme për automjetet si dhe për kembesoret.

Gjë që bën të mundur një vështirësi për qytetarët që të lëvizin në zonë. Mungesa e një terminali për autobuzat, parkimin e automjeteve etj. Një problem tjetër në lidhje me zonën ka të bëjë dhe me mungesën e një hapësirë tregtare ushqimore , rekreative, kulturore për banorët por, dhe për turistët e vendit. Këto problematika që pasqyrojmë , me anë të një plani arkitektonik mund të zgjidhen në një mënyrë sa më efektive, duke polotësuar kërkesat dhe nevojat e qytetarëve .

OBJEKTIVAT, QËLLIMI DHE REZULTATET E PRITURA

3.4. Objektivi i Përgjithshëm

Ky projekt synon evidentimin e problematikave që lindin nga mungesa e infrastrukturës fizike ,si dhe vlerësimin e nevojave të tjera për të plotësuar maksimalisht standardet dhe normativat ligjore që parashikohen nga kuadri ligjor në fuqi.

3.5. Qëllimi

1. Të promovojë kualitetin e një hapësirë të hapur dhe të aksesueshme të mirëpërdorur dhe vlerësuar ;
2. Të ruajë dhe të përditësojë vlerat e jetës historike dhe kulturore të qytetit;
3. Të promovojë zhvillimin e turizmit vendas dhe të huaj;
4. Të mundësojë ekspozimin dinjitoz të historisë industriale dhe vlerave që mban zona;
5. Të lexojë më së miri funksionet që krijohen që nga krijimi e përcaktimi i kësaj hapësirë si një përfaqje e së nesërme;
6. Të promovojë aftësinë e akomodimit të eventeve publike në hapësirat rekreative;
7. Të rivlerësojë të gjithë elementët e tij nën një këndvështrim integruar peizazhist dhe të traditës në lidhje me materialet ndërtimore;
8. Të rehabilitojë hapësirën kryerekreative si një zonë këmbësore;

9. Ridizenjimin e hapësirave të kombinatit mekanik nën një këndvështrim të ri;

4. KËRKESAT FUNKSIONALE DHE TE PROJEKTIMIT

OBJEKTET

Të dhëna të përgjithshme dhe gjendja ekzistuese e objekteve

Zona e destinuar për ndërhyrje do të jetë ;

- ❖ Ridizenjimin e hapësirave të kombinatit mekanik nën një këndvështrim të ri,
- ❖ Krijimi i një hapësire për konferenca,
- ❖ Krijimi i një hapësire akomoduese për evente publike ,

Kërkesa projektimi të përgjithshme për ndërtimin e godinave

Projektuesi do të kryejë të gjithë punën në përputhje me standardet e projektimit dhe ndërtimit që janë në fuqi në Shqipëri, si dhe me një qasje sa më të mirë të normave të projektimit europiane.

3. Kërkesa mbi kondicionet konstruktive dhe funksionale

Në të gjithë ambientet e kombinatit mekanik duhet që të krijohet kushte komoditeti të përshtatshme për vizitorët .

Faktorët mesatarë për reflektimin e dritës

Ndriçimit duhet t'i kushtohet shumë rëndësi për çdo zonë veprimtarie pasi është element kyç për të krijuar një ambient sa më të ngrohtë. Në dhomat me ndriçim të varfër natyral lejohet një maksimum prej 500 lx. Dhomat që nuk kanë dritare në tavan apo dritare të jashtme, duhet të pajisen me tuba përcjellës së dritës natyrale.

Sistemi i ndricimit

Gjatë projektimit duhet patur parasysh që ky sistem do të përfshijë sa më qartë :

- Skemat e ndricimit normal
- Skemat e ndricimit emergjent
- Skemat e ndricimit të evakuimit (Sinjalizimit)

Standarti i izolimit

Izolimet duhet të jenë të një standarti të lartë. Ai duhet të projektohet për të rezistuar në një temperaturë kritike minimale (-12.6° C) dhe lageshtie relative të ajrit 40- 60%. Urat termike janë pika të dobëta termike të lokalizuara në mbulesën transmetuese termike të ndërtesës. Në krahasim me sipërfaqet e pashqetësuara të elementeve konstruktive, në këto pika ndodh një humbje e madhe termike nga brenda jashtë. Sa më i lartë standardi energjitik i një ndërtese, aq më rëndësi është eliminimi i urave termike. Këshillohet që gjatë projektimit të mënjanohej strukturat me shumë degëzime dhe të vendosen ndarje termike të elementeve konstruktive konsol (pallakat e ballkonit, kollonat, konsolat mbajtëse) me strukturat në kufi;

Konstruksioni

Sistemi i Ventilimit

Sistemi i Ventilimit duhet të projektohet në mënyrë që të arrihet të plotësojë qëllimet kryesore si:

- Duhet të arrihet të plotësojë kërkesën për ventilim dhe furnizim me ajër të freskët për nevojat e frymshkembimit të personave që do përdorin këto ambiente.
- Duhet të sigurojë largimin e ndotesve dhe aromat e keqja nga ambientet duke bërë të mundur permiresimin e cilësisë së ajrit. Mundësisht të rregullojë dhe përqendrimin e lageshtitise të ajrit në ambiente.
- Permiresimin e komfortit termik duke ruajtur regjimin termik të impianteve të ngrohjes/ftohjes.

Impianti i ventilimit është i domosdoshëm për cilësinë e ajrit të ambienteve vecanerisht kur këto ambiente mbipopullohen.

Tipet e impiantit të ventilimit janë :

- Ventilim Natyral
- Ventilim Mekanik

Perzgjedhja e tipologjisë së sistemit duhet të bëhet në mënyrë kujdesëshme dhe duke analizuar një sërë faktorësh që kanë të bëjnë me klimën e zonës në të cilën objekti është i vendosur si dhe arkitektura e objektit.

Ventilimi natyral

Ventilimi natyral nënkupton futjen e ajrit të jashtëm nëpërmjet hapësirave fikse ose pjesëve të hapëshme si dritare ose dyer që lidhen direkt me ambientin e jashtëm.

Nese ventilimi natyral eshte i papershtatshem ose i pamjatueshem per te arritur parametrat e kerkuar te nevojshem te ambientit atehere ne keto ndertesa duhet te aplikohet ventilim mekanik.

Ventilimi mekanik

Ventilimi mekanik eshte metoda e transferimit te ajrit te fresket në ambientet e brendshme duke perdorur nje sistem ventilatoresh dhe kanale ajri ne menyre qe te fitohet nderrimi i sasise se ajrit te nevojshem per te fituar nje ambient me parametra te kenaqshem per zhvillimin normal te aktivitetit.

Sistemi i ventilimit mekanik duhet te projektohet duke pasur parasysh qe te sigurojë:

- a. Shperndarje te rregullt te ajrit.
- b. Nivel zhurme të ulet.
- c. Nje operim me kosto te ulet.
- d. Nje filtrim te mire te ajrit.

5. Llogaritjet, specifikimet teknike dhe preventivi

Kosto totale do të përcaktohet nga preventivi përfundimtar i objektit, që do të përgatitet bazuar në projektin e zbatimit, specifikimeve teknike, relacionin, si dhe duke marrë parasysh dhe kërkesat e veçanta të Bashkisë në lidhje me standardet e pranuar.

Në hartimin e preventivit çmimet e referencës do të jenë sipas legjislacionit në fuqi, mbështetur në Manualin Teknik të Çmimeve VKM nr. 627, datë 15.09.2015. Për zërat e punimeve që nuk gjenden në manual, projektuesi duhet të hartojë analiza përkatëse, të cilat do ti bashkëlidhen të detajuara projekt zbatimit, kjo për të siguruar kursimin dhe eficientë e përdorimit të fondeve.

Preventivi do të paraqitet sipas Formatit/ Modelit të rekomanduar nga Bashkia.

6. Realizimi i Projektit

Projektet duke te realizohen duke ju referuar VKM Nr. 354, datë 11.5.2016 “Për Miratimin e Manualit të Tarifave për Shërbime në Planifikim Territori, Projektim, Mbikqyrje dhe Kolaudim”, duhet të kalojë në këto faza:

FAZA I Analiza e detyrës së projektimit

Analiza e detyrës së projektimit/ termave te referencës dhe përcaktimi i bazës së projektit. Gjetja e kushteve për zgjidhjen e detyrës nëpërmjet planifikimit. Ajo duhet të përfshijë një analizë të argumentuar të çështjeve/ kërkesave kryesore të trajtuara në detyrën e projektimit.

FAZA II Projekt ide paraprake (Përgatitja e projektit dhe planifikimit)

Përpunimi i pjesëve të rëndësishme të një zgjidhjeje të detyrës së planifikimit, e cila do paraqitet në jo më pak se 2 variant- propozime.

FAZA III Projekt ide përfundimtare (planifikimi i sistemimit dhe i integritit)

Përpunimi i zgjidhjes përfundimtare të detyrës së planifikimit.

Pas miratimit në Këshill Teknik të variantit socio- ekonomik dhe teknik më të përshtatshëm të miratuar në fazën e projekt idesë paraprake, procedohet me projekt- idenë përfundimtare e cila do të përmbaje të gjithë raportet dhe perlllogaritjet e kesaj faze me qellim vleresimin para përfundimtar te konditave dhe kushteve te zhvillimit te projektit.

FAZA IV: Projekti për miratimin e lejes së ndërtimit: Përpunimi dhe dorëzimi i dokumentave për procedurat e nevojshme juridike e ligjore.

Projektuesi gjithashtu duhet të parashikojë dhe projektin për miratimin e lejes së ndërtimit, i cili duhet të mbështetet në ligjin nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”. Për këtë për çdo dokumentacion të nevojshëm për hartimin e projektit si dhe për aplikimin për leje ndërtimi përmes portalit të Regjistrisë të Integruar të Territorit, të bashkëpunohet me Drejtorinë përkatëse të Bashkisë Polican.

FAZA V: Projekti zbatimi: Përpunimi dhe paraqitja e planit të zgjidhjes së gatshme për zbatim.

Dosja e plotë e projektit të zbatimit për cdo objekt duhet të përmbajë:

Raportet teknike Planvendosjen e objektit

Planimetritë

Rilevimin topografik

Projektin arkitektonik

Specifikimet teknike për zërat e punimeve që do të kryhen;

Preventivin e punimeve mbështetur në manualet teknike të çmimeve në fuqi;

Grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të punës;

Plan organizimin e punimeve dhe ngritjen e kantierit në funksion të mjeteve, që do të jenë pjesë e realizimit të objektit, mbështetur dhe në grafikun e punimeve;

FAZA VI: Hartimi i preventivit përfundimtar

Për hartimin e preventivit projektuesi duhet të mbështetet në VKM NR. 629, datët. 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”. Për secilin zë punimi, i cili nuk është i përfshirë në këtë manual, projektuesi duhet të dorëzojë analizat/ ofertat përkatëse të çmimeve.

Në hartimin e preventivit, veç të tjerave do të mbahen parasysh sa më lart, lidhur me organizimin e zbatimit me faza, çmimet e referencës sipas akteve ligjore në fuqi, dhe llogaritja e preventivit do të bëhet sipas normave dhe akteve ligjore në fuqi për të siguruar kursimin dhe efikasitetin e përdorimit të fondeve.

Preventivi do të përpilohet sipas formatit/modelit standart të rekomanduar nga Bashkia Polican.

7. Rekomandime për projektuesin

Projektuesi duhet të përdorë dhe të rishikojë të gjithë informacionin ekzistues lidhur me zonën ku ndodhen objektet subjekt te projekteve, sistemin ekzistues të largimit të ujërave,

sistemin e furnizimit të zonës me ujë të pijshëm, distancat e lejuara si dhe kriteret urbane të zonës në fjalë.

Standarde në Projektim

Projekti do të hartohet në përputhje me të gjitha normat dhe standardet për projektim që parashikon legjisllacioni në fuqi. Projektimi duhet të sigurojë respektimin e standardeve, madje edhe atyre gjatë zbatimit. Është përgjegjësi e projektuesit saktësia dhe respektimi i të gjitha standardeve dhe normave përkatëse.

Projektuesi mund të rekomandojë edhe prezantimin e standardeve të reja, për përafrimin me normat e BE-se, si dhe të praktikave më të mira ndërkombëtare në projektim dhe zbatim.

Në hartimin e projektit të mbahen parasysh normat e miratuara për personat me aftësi të kufizuar, të verbrit, etj. Në projekt të parashikohet infrastruktura e nevojshme për këtë kategori.

Detajet teknike të infrastrukturës për këtë kategori, të jepen nga projektuesi në Fletë të veçanta të Projektit.

Standarde në paraqitjen e dokumentacionit teknik

Në hartimin dhe paraqitjen e dokumentacionit të projektit, projektuesi të përdorë programet e kërkuara kompjuterike, si dhe të nxitet përdorimi i programeve të reja, më të avancuara të fushës.

Dorëzimi

Dorëzimi i tyre do të bëhet në rrugë zyrtare shoqëruar me liste dokumentash. Ato duhet të jenë të firmosura nga projektuesi.

Materiali grafik duhet të jetë në format A3 (3 kopje).

Vizatimet në formë dixhitale të jenë file .ACAD (“vizatim.dwg”).

Raportet teknike të çdo studimi si dhe raporti teknik përmbledhës në format A4 (3 kopje).

I gjithë materiali duhet të paraqitet në 3 kopje (hard copy & cd).

Ne CD 1 kopje e të gjithë materialit të jetë format pdf dhe format të editueshem dwg.

Menaxhimi i Projektit

Autoriteti përgjegjës për menaxhimin e projektit është Bashkia Polican me strukturat e saj përkatëse.

Koha e përgatitjes së projektit

Për realizimin e këtij projekti duhet afati kohor si më poshtë:

Projekt Ideja do të dorëzohet 15 dite nga data e nënshkrimit të kontratës midis Bashkise Polican dhe Konsulentit.

Projekt Zbatimi do të dorëzohet 45 dite nga miratimi i Projekt Idese nga ana e Autoritetit Kontraktor apo institucioneve te tjera kompetente.

*Koha qe do te nevojitet per miratimet e fazave te projektit nga institucionet perkatese nuk do te perfshihet ne kohen e pergatitjes se projektit nga ana e konsulentit.

Oponenca teknike

- Mbas hartimit te kesaj faze (projekt-zbatimit) dokumentacioni do ti nenstrohet oponences teknike bazuar ne V.K.M. Nr.363, dt.18.07.2002 “Per vendosjen e oponences teknike per projektet e ndertimit te objekteve”.

Shtojca 11

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 12.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

- Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit².

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 12*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 5;*

2. **Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. Sipas pikes 1 te shtojces 11 (Kriteret e Pergjithshme per Kualifikim).

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim nga administrata tatimore për xhiron mesatare vjetore për 3 vitet e fundit financiare(2020,2021,2022) nga data e zhvillimit te tenderit leshuar nga autoriteti perkates , ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo me e vogel se 40 % e vleres se perlllogaritur te kontrates qe prokurohet.

² Në këtë marrëveshje nuk duhet të përcaktohet përqindja e shërbimeve të secilit anëtar, por fushat/ekspertizat e marra përsipër për tu realizuar.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

2.2.2 Kopje të çertifikuara të bilanceve tre viteve të fundit financiare, (2020,2021,2022) të paraqitura dhe të konfirmuara në autoritetet përkatëse Dega e tatim taksave që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar vetëm në rastet kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma "c", të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009. Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjeshme nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023 sipas kësteve të parashikuara në ligjin nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar;

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë **duhet të vetëdeklarojnë se kanë paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2023 sipas kësteve të parashikuara në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.**

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar duhet të dorëzojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

2.3 Kapaciteti teknik:

Shërbime të ngjashme të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, me vlerë jo më të vogël se 40 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet.

- a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik do të vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur kontratën përkatëse, vërtetim për realizimin e plotë dhe të suksesshëm të kesaj kontrate, ku të jetë përcaktuar kohëzgjatja e shërbimit, vlera e shërbimit të realizuar.

- b) Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me subjekte private, Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur faturat tatimore perkatase të shitjes , të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e procedurave të prokurimit “Shërbim konsulence”, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.

2.3.1 Liçensa profesionale të operatorit ekonomik (e vlefshme) për projektim (lëshuar nga MZHUT ose nga Institucioni i Autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e licensave profesionale në fushën e studimit e projektimit në ndërtim), ku të përfshihen kategorite:

kat.1.c-Plane te detajuara vendore

kat 2. PROJEKTUES ARKITEKT

b-2) Objekte arsimore

c-Projektim interiere

d) Projektim peisazhi, sistemim siperfaqe te gjelbërta, lulishte e parqe.

Kat 3 PROJEKTUES KONSTRUKTOR

a)Projektim objekte civile-industriale-turistike prej murature eb skelet betoni deri ne 5 kate

b)1.Objekte civile -industriale-turistike mbi 5 kate -2.objekte me skelet metali

c)Projektim:1. Objete me shkalle te larte veshtiresie Beton-arme-metalike -2. troje dhe shpate me qendruehmeri te ulet.

kat 4.PROJEKTUES INSTALATOR

a)projektim te instalimeve hidro-termosanitare

b)Projektim te instalimeve termoteknike-kondicionimi, si dhe te inpianteve te prodhimit te energjise termikenga burime te rinovueshme

c)Projektim te linjavee rrjeteve elektrike per objekte civile industriale

f)Projektim te sistemeve kundra zjarrit

h)projektimi i impianteve ngritese e transportuese(ashensore, shkalle levizese etj)

i- Projektim te rrjeteve te telefonise , citofonise, fonise, internetit, tv, access kontroll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedikimit te zjarrit etj.. per objekte civile dhe industriale.

kat5. PROJEKTUES VEPRA HIDRAULIKE

b) Projektim furnizimi me uje- kolektore shkarkimi

kat 8. PROJEKTUES GJEODET

a) Rilevime inxhinierike

b)Rivelim inxhinierike kadastrale

c)Sistemi GIS

d)Bazamente gjeodezike

e)Projektim fotogrametrik dhe hartografik

kat 9. STUDIME GJEOLLOGOJIKE INXHINERIKE-HIDROGJEOLOGJIK

a) Studim Vlersim gjeollogo-inxhinierik i truallit per objekte civile -ekonomike deri 5 kate

b) Studim Vlersim gjeollogo-inxhinierik per objekte civile -ekonomike mbi 5 kate

10. PROJEKTIMI I IMPIANTEVE TE PRODHIMIT DHER SHPERNDARJES SE ENERGJISE ELEKRIKE

e) Projektim gabina elektrike te rjetit shperndares-linja te tensionit te ulet-te mesem

Kat.12. STUDIME TE SIZMOLOGJISE INXHINIERIKE

b) studime/vleresime gjeologo/sizmike per trojet ku ndertohen objektet civile, sociale e kulturore

(Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës).

*Sqarim: Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr.943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave ‘Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë **Liçensa profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për projektim (leshuar nga MZHUT** ose institucione të tjera të autorizuara sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e liçensave profesionale në fushën e studim projektimit në ndërtim), e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mësipërme me ndryshimet përkatëse në emërtesë.*

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet te ketë si drejtues teknik stafin si më poshtë dhe te jenë te perfshirë ne listpagesën e shoqërisë për muajin e fundit te deklaruar:

Per stafin e mesiperm Operatori Ekonomik duhet te paraqese:

- I. 2 dy arkitekt
- II. 2 dy inxhinier ndertimi profili strukturiste
- III. 2 dy inxhinier hidroteknik
- IV. 2 dy inxhinier gjeodet
- V. 2 dy inxhinier gjeolog
- VI. 2 dy inxhinier elektrik
- VII. 2 dy inxhinier mekanik
- VIII. 1 inxhinier mjedisi i pajisur me certifikate leshuar nga Agjencia per Eficensen e Energjise per Menaxher Energjie

Per stafin e mesiperm Operatori Ekonomik duhet te paraqese:

Kontratrat individuale te punes (të vlefshme), Licencat profesionale, Diplomë, CV .

Një projektues nuk duhet të jetë i angazhuar njëkohësisht në stafin e dy shoqërive që marrin pjesë në procedurën e prokurimit.

Stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë (shtojca 7)

Shënim: Sqarojmë se në përmbushjen e kriterit të sipërcituar, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.12, ku të deklarohet disponimi i punonjësit të sipërcituar dhe deklaratat e disponueshmërisë së stafit.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: Operatorët ekonomik të kualifikuar të fazës së parë (lista e shkurtër), duhet të dorëzojnë pranë AK, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet të paraqitura në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

2.3.3 Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë si staf mbështetës ku të figurojnë 3 muajt e fundit në listpagese ,si më poshtë:

3(tre) arkitekt

2(dy) inxhinier ndertimi

1(nje) inxhinier gjeolog

2 dy inxhinier hidroteknik

2(dy) Ekspert Zjarrefikes

2(dy) Inxhinier IT/Telekomunikacioni/Elektronik/Sistemes

2 punonjes te pajisur me certifikate si "Pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit ne pune" ne perputhje me klauzolat e ligjit nr.10237 date 18.02.2010 "Per sigurine dhe shendetin ne pune" dhe VKM nr 312, date 05.05.2010 "Per miratimin e rregullores "Per sigurine ne kantier"

2 punonjes te pajisur me certifikate leshuar nga Ministria e Mjedisit per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis

1 punonjes i pajisur me certifikate per pergjegjes dhe administrimin e mbrojtjes ne mjedis

Per punonjësit e mesiperm Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

Kontratat individuale të punës (të vlefshme), Diplomë, CV

Një projektues nuk duhet të jetë i angazhuar njëkohësisht në stafin e dy shoqërive që marrin pjesë në procedurën e prokurimit.

Shënim: Sqarojmë se në përmbushjen e kriterit të sipërcituar, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.12, ku të deklarohet disponimi i punonjësit të sipërcituar dhe deklarata e disponueshmerise se stafit.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

